

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projekt-ligji për disa ndryshime ne ligjin 102/2015 “Per sektorin e gazit natyror” te ndryshuar
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Mbështetur në Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, ”Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, si dhe Rregullores (BE) 2017/1938 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të dates 25 tetorit 2017, lidhur me masat për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz, e cila ka shfuqizuar Rregulloren (BE) Nr. 994/2010, janë ndërrmarë veprimet përkatëse për përshtatjen e rregullores (BE) 2017/1938
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	1-Vendimi nr. 87, datë 14.02.2018 “Për miratimin e planit të zhvillimit të sektorit të gazit natyror në shqipëri dhe identifikimin e projekteve prioritare”. 2-Vendimi Nr. 480, datë 31.7.2018 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Enea Karakaçi, Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator enea.karakaci@infrastruktura.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
OBJEKTIVAT <i>Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?</i>	

Ky projekt akt konsiston në përditësimin dhe krijimin e elementëve të rinj që kanë të bëjnë me sigurinë e furnizimit me gaz natyror. Rregullorja (EU) 2017/1938 e Parlamentit Europian konsiston në masat që duhet të merren për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz. Rregullorja (EU) 2017/1938 për të cilën do të bëhen edhe ndryshimet në ligjin 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar, ka në thelbin e saj planin e veprimit parandalues dhe një plan emergjence i cili konsiston në masat e nevojshme për të garantuar sigurinë e furnizimit me gaz. Përgatitja e një plani veprimi parandalues do të sillte një reagim me efikas në përballimin e ndonjë krize të furnizimit me gaz. Duke pasur një vlerësim mbi sigurinë e furnizimit dhe aplikimin e masave parandaluese do të sillti avantazhe në përdorimin me efikasitet të një furnizimi konstant në situata emergjence. Duke bashkëpunuar me shtete e anëtare të Komunitetit të Energjisë përballimi i situatave emergjente do të rriste gadishmërinë për një qasje më të plotë dhe efikase. Në raste emergjente koordinimi i shteteve anëtare do të rriste sigurinë e furnizimit me gaz.

Një pikë tjetër e rregullores (EU) 2017/1938 që do të shtohet në ligjin e gazit 102/2015 lidhet me situata që do të krijohen në një gjendje krize, ku në varësi të shkallës së krizës që do krijohet do të ndahet në tre kategori si më poshtë;

- a) niveli i paralajmërimit të hershëm ('paralajmërimi i hershëm');
- b) niveli i alarmit (alarmi);
- c) niveli i emergjencës (emergjenca)

Kjo pikë reflekton veprimet që duhet të merren në raste krizash të furnizimit me gaz, në bazë të vlerësimit të nivelit të krizës do hyjnë në veprim masat për menaxhimin e krizës. Ministria përgjegjëse për energjinë mban rolin kryesor për marrjen e masë në raste emergjence si dhe bashkëpunon me institucionet e tjera vendore dhe qendrore si dhe me aktorët e tjerë përgjegjës të tregut për menaxhimin e situatës së emergjencës. Në raste të emergjencës ministria përgjegjëse për energjinë mban kontakte të ngushta me Sekretariatit e Komitetit të Energjisë duke e vënë në dijeni për çdo plan masash që do të zbatohet për të përballuar nivelin e krizës.

Pjesë e rregullores (EU) 2017/1938 e cila do të shtohet në ligjin 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar, është edhe solidariteti midis shteteve anëtare të Komitetit të Energjisë dhe vendosjen e masave për arritjen e qëllimeve. Solidariteti nënkupton bashkëpunimin rajonal dhe angazhimin e autoriteteve publike dhe subjeteve të gazit natyror për të minimizuar rreziqet e identifikuar dhe të rrisë efikasitetin e masave. Mekanizmi i solidaritetit është një masë për të ruajtur sigurinë e furnizimit me gaz duke përballuar situatat e vështira.

Objektivat e synuara të propozimit janë si më poshtë:

- Të garantohet siguria e furnizimit me gaz në situata emergjence.
- Bashkëpunimi me vendet e traktatit të energjisë si dhe me vendet e rajonit
- Përgatitja e një plani parandalues

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës së propozuar, janë shqyrtuar tre opsione:

“Opsioni 0” – Ruajtja e “status quo-së”, ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar

“Opsioni 1” – Perditesimi i ligjit mbeshtetur ne direktiven dhe rregulloren e Bashkimit Evropian

“Opsioni 2” – Mbeshtetur ne opsionet me te mira nderkombetare per krijimin e nje ambineti te qendrueshme politiko-ekonomik

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet e opsionit të preferuar janë si vijon:

- **Ndikimi ekonomik** sasior– Ndryshimet e propozuara me anë të këtij projektligji momentalisht nuk kanë nje impakt ekonomik.

Ndikimi cilësor – Ndryshimet në projektligjin e propozuar do te ndikojne ne:

- Përmirësimin e kuadrit te masave qe do te merren per te siguruar burime alternative te gazit natyror ne kushtet e rasteve emergjente
- Ndikimi ne te gjitha ato subjekte private apo shtetore si edhe individe qe zoterojne akses ne rrjetin e furnizimit me gaz natyror duke ofruar siguri
- Rritjen e investimeve në veprimtarinë e subjekteve te cilat proceset teknologjike do te vihen ne shfrytezim nepermjete gazit natyror
- **Ndikim mjedisor**, nuk ka nje studim te mirefillte mbi impaktin mjedisor
- **Ndikim social**, nuk ka nje studim te mirefillte mbi impaktin social

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 1. Perditesimi i ligjit lidhet me faktin se Shqiperi eshte vend kandidat per antaresim ne strukturat e Bashkimit Evropian. Ne baze te Marreveshjes Stabilizim Asocimit qe vendi yne ka me Bashkimin Evropian Shqiperia ka detyrimin ne peraftrimin e akteve ligjore me BE. Nje nga keto akte ligjore te peraftrimit eshte edhe Direktiva 2009/73/KE e Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, ”Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, si dhe Rregullores (BE) 2017/1938 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të dates 25 tetorit 2017, lidhur me masat për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz. Mbeshtetur ne kete direktive dhe rregullore MIE ka inicuar perditesimin e ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Projektligji nuk parashikon direkt të ardhura dhe shpenzime buxhetore, por si një ligj që do të mbështesë dhe kontribuojë direkt në zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri dhe realizimin e projekteve konkrete në këtë sektor, do të përbëjë një bazë të rëndësishme për tërheqjen dhe mbështetjen e investimeve strategjike në këtë sektor.

Viti 1	Viti 2	Viti 3
n/a	n/a	n/a

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Ende nuk janë realizuar konsultimet dhe marrja e vendimeve me aktoret e ndryshme që përfshijn fusha e gazit natyror.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe strukturat përgjegjëse të saj do të monitorojnë zbatimin e procedurave të parashikuara në ligjin e ri.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji Nr. 102/2015, datë 23.09.2015 “Për sektorin e gazit natyror” përcakton rregullat për zhvillimin e veprimtarisë në sektorin e gazit natyror. Në kuadër të politikave për përmirësimin e furnizimit të konsumatorëve të shumtë me produkte energjetike të garantuara edhe nëpërmjet zgjerimit të llojeve dhe burimeve të furnizimit të tyre, u hartua dhe u miratua ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, cili përbën një element kryesor në Kuadrin Rregullator Ligjor dhe Teknik për organizimin dhe funksionimin e tregut të gazit natyror, në të cilin janë përcaktuar praktikat ligjore e teknike për aktivitetin e furnizimit dhe shpërndarjes së gazit në treg, raportet me konsumatorët, si dhe për rolin rregullator të shtetit në këtë treg. Në këtë mënyrë u arrit gjithashtu që të krijohen edhe kushtet e nevojshme ligjore për të marrë në konsideratë dhe trajtuar në rrugë institucionale propozime-projektet e paraqitura për furnizimin e vendit tonë me gaz natyror, projekte të cilat synojnë gazifikimin e vendit edhe nëpërmjet lidhjes me rrjetet rajonale të gazsjellësve, si dhe më pas nëpërmjet ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës së nevojshme të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Territorin Shqiptar.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Aktualisht Shqipëria ende nuk zoteron një sistem të transmetimit dhe shpërndarjes të gazit natyror, dhe të përshkruash natyrën e problematikes mendojme se është ende heret akoma me shumë kur ky projekt-ligj konsiston në menaxhimin e rasteve të emergjencës në shkallë vendi dhe rajonale.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja në këtë ligj është e nevojshme pasi mbështetur në Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, si dhe Rregullores (BE) 2017/1938 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetorit 2017, është përditësuar kuadri i rregullores që lidhet me masat për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz. Nisur ky fakt Ministria e Infrastrukurës dhe Energjisë në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë është angazhuar në përshtatjen e ketyre rregullave të cilat do të bashkangjiten ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Do të rritet siguria e furnizimit me gaz natyror në kushtet e emergjencës
- Vendosja e bashkepunimi me vendet e rajonit për të përballuar nevojat me gaz natyror në kushtet e emergjencës
- Kordinimin e planit të emergjencave me vendet e rajonit në bashkepunim me Sekretariatën e Komunitetit të energjisë

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Janë identifikuar tre opsione të mundshme, si vijon:

Opsioni 0 – Ruajtja e “status quo-së”, ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar

“**Opsioni 1**” – Perditesimi i ligjit mbeshtetur në direktiven dhe rregulloren e Bashkimit Evropian

“**Opsioni 2**” – Mbeshtetur në opsionet me të mira nderkombetare për krijimin e nje ambineti të qendrueshme politiko-ekonomik

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

- *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë. Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i përzgjedhur është opsioni nr 1, për për arsytet si më poshtë vijon:

Me arsyetimin dhe argumentat si më sipër, duke vlerësuar në tërësi përmbajtjen e Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, "Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, si dhe Rregullores (BE) 2017/1938 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetorit 2017, lidhur me masat për të mbrojtur sigurinë e furnizimit me gaz, Shteti Shqiptar duke qënë pjesë e Komunitetit të Energjisë ka detyrimin mbi përshtatjen e Direktivave dhe Rregulloreve që mbulojnë sektorin e gazit natyror. Për këtë arsye, në ndryshimin që propozohet të bëhet në ligjin Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", të ndryshuar, kërkohet që disa elemente të Rregullores (BE) 2017/1938 të adoptohen dhe përshtaten në ligj.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të përzgjedhur njësia përgjegjëse do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe strukturat përgjegjëse të saj.

Për zbatimin e këtij opsioni nuk parashikohen pengesa duke qënë se pas ndryshimit të propozuar e vetme njësi përgjegjëse zbatimit e ndryshimeve ligjore është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me strukturat përgjegjëse të saj.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të zbatimit të objektivit të politikës do të ndërmarr masat e nevojshme:

- *Ndryshimet në aktet nënligjore që preken nga ky projektligj.*
- *Informimin e grupeve të interesit të prekura nga këto ndryshime.*

Faza e shqyrtimit/vlerësimit.

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim monitorimin dhe zbatimin e opsionit të preferuar, do të komunikojë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë vendet e rajonit dhe do të mbledhë prej tyre mendime, në zbatim të planit të emergjencës në raste krizash.

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, do të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, nenit 6/1 dhe nenit 9.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

(Momentalisht nuk ka impakt buxhetor)

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			